



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja - Ministry of Economic Development

BALANCA VJETORE E ENERGJISË
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2016

GODIŠNJI ENERGETSKI BALANS
REPUBLIKE KOSOVA ZA 2016. GODINU

ANNUAL ENERGY BALANCE OF
REPUBLIC OF KOSOVO FOR THE YEAR 2016

Prishtinë, 2015



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja - Ministry of Economic Development

BALANCA VJETORE E ENERGJISË
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2016

Prishtinë, Dhjetor 2015

Ky dokument është përgatitur nga Divizioni i Politikave të Energjisë në MZHE. Pa mbështetjen dhe bashkëpunimin e ngushtë me entitetet e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ për Rregullat për Balancat e Energjisë, ky dokument nuk do të mund të përgatitej.

Përmbajtja

Shkurtesat

1. Hyrje	4
2. Furnizimi me produkte energjetike për periudhën 2013-2015	5
3. Konsumi final i energjisë për periudhën 2013-2015.....	6
3.1. Konsumi sipas llojeve të produkteve të energjisë.....	6
3.2. Konsumi i energjisë sipas sektorëve të ekonomisë.....	7
3.2.1. Sektori i industrisë	8
3.2.2. Sektori i amvisërisë	9
3.2.3. Sektori i shërbimeve.....	9
3.2.4. Sektori i bujqësisë	10
3.2.5. Sektori i transportit.....	11
4. Parashikimi i kërkesës për energji për vitin 2016.....	11
4.1. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e amvisërisë.....	12
4.2. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e shërbimeve	13
4.3. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e industrisë	13
4.4. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e transportit	14
4.5. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e bujqësisë.....	15
4.6. Parashikimi i nevojave të përgjithshme (totale) për konsumin final të produkteve të energjisë për vitin 2016.....	15
5. Parashikimi i humbjeve të energjisë për vitin 2016.....	16
5.1. Humbjet e energjisë elektrike	16
5.2. Humbjet e ngrohjes qendrore.....	16
6. Parashikimi i prodhimit të energjisë elektrike për vitin 2016.....	17
6.1. Parashikimi i prodhimit të energjisë elektrike nga termocentralet.....	17
6.2. Parashikimi i prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet dhe burimet e ripërtitshme	17
6.3. Parashikimi i importit të energjisë për vitin 2016.....	18
7. Parashikimi i emetimit të ndotësve nga termocentralet	19
7.1. Emetimet specifike të TC Kosova A	20
7.2. Emetimet specifike të TC Kosova B.....	20
8. Indikatorët e efijencës së energjisë së termocentraleve	21
Shtojca 1. Balanca vjetore e energjisë për vitin 2016.....	22

Shkurtesat

MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
KOSTT sh.a	Operatori i Sistemit dhe Tregut
KEK	Korporata Energjetike e kosoves
KES/CO	Kompania furnizim me energji elektrike
KEDS	Kompania per distribuim me energji elektrike
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ZRrE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
MF	Ministria e Financave
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
APK	Agjensioni Pyjor i Kosovës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë
SKE	Sekretariati i Komunitetit të Energjisë
REKOS	Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2011
CRES	Qendra për burime të ripërtritshme dhe kursimin e energjisë, Athine-Greqi
EUROSTAT	Enti i Statistikave i Komunitetit Evropian
IEA	Agjencioni Ndërkombëtar i Energjisë
GLN	Gazi i Lëngëzuar i Naftës
TC	Termocentral
HC	Hidrocentral
GWh	Giga Vat Orë
GW	Giga Vat
MWh	Mega Vat Orë
MW	Mega Vat
BRE	Burime të Ripërtritshme të Energjisë
BPV	Bruto Produkti Vendor

1. Hyrje

Dokumenti “Balanca Vjetore e Energjisë e Republikës së Kosovës për vitin 2016” është përgatitur duke u bazuar në nenin 5 të Ligjit për Energji Nr. 03/L-184 dhe Udhëzimin Administrativ “mbi Rregullat për Balancat e Energjisë”, Nr.07/2011. Qëllimi i këtij dokumenti është të informojë të gjithë të interesuarit për parashikimin e kërkesës për energji për vitin 2016.

Dokumentet bazë për hartimin e këtij dokumenti kanë qenë:

- Balancat e Energjisë së Kosovës për vitet 2013, 2014 dhe 2015;
- Balanca e Energjisë Elektrike për vitin 2016, hartuar nga KOSTT-i;
- Balanca Elektroenergjetike 2016, hartuar nga KEK-u;
- Balanca vjetore 2015-2016, hartuar nga Ngrohtorja Termokos sh.a. Prishtinë;
- Balanca vjetore 2015-2016, hartuar nga Ngrohtorja e Qytetit të Gjakovës sh.a.
- Informacionet periodike mujore për vitin 2015 nga entitetet e përcaktuara në UA 2007/11 për raportimin e të dhënave të energjisë (Ndërmarrjet e energjisë, ASK etj).

Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar në bazë të kërkesave të formatit EUROSTAT. Balanca e energjisë elektrike e hartuar nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT-i) dhe miratuar nga MZHE-ja, ka shërbyer për parashikimin e kërkesave për energji elektrike dhe mënyrën e mbulimit të tyre. Balancat vjetore të ngrohjeve të qytetit të Prishtinës dhe Gjakovës kanë shërbyer për parashikimin e kërkesave të ngrohjes si dhe mbulimin e tyre. Balancat vjetore të hartuara nga MZHE-ja kanë shërbyer si bazë për të përcaktuar trendin e zhvillimit të kërkesave të burimeve tjera të energjisë (druri, produktet e naftës, energjia solare, etj.) për vitin 2015.

Pjesët themelore të balancës së energjisë sipas formatit të EUROSTAT-it janë:

- Pjesa e parë ka të bëjë me produktet energjetike primare, atyre të përfituara, importet, eksportet dhe stoqet për të gjitha produktet energjetike.
- Në pjesën e dytë paraqiten transformimet e produkteve primare në ato sekondare. Në këtë grup futen transformimet e energjisë në të gjitha centralet për transformim të produkteve të ndryshme energjetike në energji elektrike, impiantet për prodhimin e produkteve energjetike të patentuar dhe briketim, impiantet e gazifikimit, furnaltat, ngrohje qendrore, panele solare. Këtu përfshihen edhe shkëmbimet dhe transferet e produkteve energjetike.
- Në pjesën e tretë paraqiten humbjet e energjisë në shpërndarje dhe transmision (përfshirë të gjitha produktet energjetike).
- Në pjesën e katërt paraqitet shpenzimi vetanak nga dega e energjisë dhe konsumi i përgjithshëm final. Në shpenzimet e energjisë përfshihen të gjitha shpenzimet e lidhura me procesin e punës së impianteve energjetike.
- Pjesa e pestë lidhet me konsumin final të produkteve të energjisë. Në këtë grup përfshihet konsumi i të gjitha produkteve energjetike që shpenzohen nga pesë sektorët ekonomikë: amvisëria, industria, shërbimet, transporti dhe bujqësia.

Duhet theksuar se konsumi i energjisë në këtë dokument është parashikuar duke u bazuar në anketa për konsumin e energjisë të realizuara nga 2009 deri në 2014. Konsumi i energjisë është studiuar si nga ana sektoriale ekonomike (sektori i industrisë, amvisërisë, shërbimeve, transportit dhe bujqësisë) ashtu edhe nga ana e llojeve të produkteve të energjisë.

Si bazë kanë shërbyer anketat e realizuara në vitin 2009 për konsumin e vitit 2008 për të gjithë sektorët ekonomikë, anketa e realizuar në vitin 2011 për konsumin e biomasës për vitet 2010 dhe 2009 në sektorët e amvisërisë, shërbimeve dhe industrisë nga CRES-i e kontraktuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe anketa për konsumin e energjisë në sektorin e amvisërisë si dhe anketat e sektorit të industrisë të realizuar në 2010 (nga MPR Group) , atij të amvisërisë në 2011 (nga InTECH), të shërbimeve në 2012 (nga Studio Links 4), të bujqësisë të realizuar në vitin 2013 (nga InTECH) dhe transportit (nga InTECH) të realizuar në vitin 2014.

2. Furnizimi me produkte energjetike për periudhën 2013- 2015

Parashikimi i konsumit të energjisë për vitin vijues (2016) bazohet në trendin e tri viteve të fundit, para vitit për të cilin bëhet parashikimi. Të dhënat e vitit 2015 bazohen mbi bazën e rritjes ekonomike të Kosovës për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, të dhënat nëntë mujore të importit dhe eksportit të produkteve të thëngjillit dhe naftës për vitin 2015 ndërsa për tre muajt e fundit janë bërë ekstrapolime, kurse të dhënat për energjinë elektrike dhe të ngrohjes janë marre nga të dhënat e parashikimit për periudhën 2014-2015.

Në Tabelën 1. paraqiten të dhënat për sasinë e produkteve primare të energjisë për vitet 2013, 2014 dhe 2015.

Tabela 1. Pasqyra e sasisë së energjisë së produkteve primare në dispozicion gjatë periudhës 2013-2015 (ktoe)

	2013	2014	2015
Thëngjill	1552.16	1351.99	1586.32
Produkte naftë	579.32	582.55	639.08
Biomasë	247.65	252.88	255.73
Energji elektrike	-28.82	42.21	-0.63
Hydroenergji	12.32	12.99	11.02
Energji solare	0.76	0.33	0.40
Energjia e erës	0.00	0.03	0.27
Totali	2363.39	2242.97	2492.20

Burimi: dokumentet e MZHE-së të balancave të energjisë




Figura 1. Pasqyra e sasisë së energjisë së burimeve të energjisë primare në dispozicion gjatë periudhës 2013-2015 (ktoe)

Siç vërehet nga Tabela 1. dhe diagrami në Figurën 1., sasia e përgjithshme(bruto) e energjisë në dispozicion në vitin 2015 është 2492.20 ktoe, ndërsa në vitin 2014 ka qenë 2242.97 ktoe. Pra, në vitin 2015 ka një rritje të sasisë së energjisë në dispozicion në masën prej 11 %. Duhet theksuar se një rritje e tillë e produkteve primare të energjisë është shkaktuar si pasojë e rritjes së prodhimit të linjtit krahasuar me vitin paraprak dhe rritjes së importit të naftës.

3. Konsumi final i energjisë për periudhën 2013-2015

Në vazhdim do të paraqiten të dhëna për sasinë e konsumuar të produkteve energjetike të ndryshme përgjatë periudhës 2013-2015. Kjo bëhet me qëllim që të paraqitet baza mbështetëse e analizave të parashikimit të kërkesave për energji për vitin 2016.

Konsumi për vitin 2013 dhe 2014 është bazuar në hulumtimin me anketa të realizuara përgjatë periudhës 2009,2010, 2011, 2012 dhe 2013.

3.1. Konsumi sipas llojeve të produkteve energjetike

Në vijim, në Tabelën 2. paraqitet konsumi i të gjitha produkteve energjetik për periudhën 2013-2015 për qëllime energjetike dhe jo-energjetike:

Tabela 2. Pasqyra e konsumit të të gjitha produkteve energjetike (ktoe) për periudhën 2013-2015

	2013	2014	2015
Thëngjill	55.95	60.34	61.34
Produkte nafte	573.58	575.87	629.84
Biomasë	247.65	253.24	255.73
Energji elektrike	399.57	402.09	451.01
Energji solare	0.76	0.33	0.40
Ngrohje e përfituar	3.67	4.06	9.21
Gjithsej	1281.18	1295.94	1407.52

Burimi: dokumentet e MZHE-së të balancave të energjisë

Nga Tabela 2. shihet se produktet e naftës paraqesin produktin energjetik që është konsumuar në sasinë më të madhe, që në tërësinë e sasisë së konsumit merr pjesë me 44.7%. Energjia elektrike zë vendin e dytë të pjesëmarrjes me 32.0%, biomasa merr pjesë me 18.2%, thëngjilli merr pjesë me 4.4%, ngrohja e përfituar merr pjesë 0.7% dhe energjia solare merr pjesë me vetëm 0.03%.

Në Figurën 2. është bërë paraqitja grafike e trendit të konsumit të energjisë sipas llojeve të produkteve energjetike për periudhën 2013-2015.




Figura 2. Pasqyra e konsumit të produkteve të energjisë në të gjithë sektorët për periudhën 2013-2015 (ktOE)

3.2. Konsumi i energjisë sipas sektorëve të ekonomisë

Në Tabelën 3. paraqitet gjendja e konsumit të sektorëve për qëllime energjetike. Siç shihet sektori i amvisërisë është sektori që ka konsumuar më së shumti energji përgjatë tri viteve të fundit. Ky sektor pasohet nga sektori i transportit. Sektori i industrisë është sektori i tretë për nga konsumi i energjisë duke u pasuar nga ai i shërbimeve. Kurse sektori i bujqësisë është sektori që ka konsumuar vazhdimisht më së paku energji.

Tabela 3. Pasqyra e pjesëmarrjes së burimeve të energjisë për qëllime energjetike tek të gjithë sektorët (ktOE)

	2013	2014	2015
Sektori i industrisë	266.63	279.54	293.07
Sektori i amvisërisë	495.52	482.38	530.58
Sektori i shërbimeve	118.79	138.53	149.35
Sektori i bujqësisë	29.34	22.24	16.68
Sektori i transportit	328.52	339.70	372.36
Gjithsej	1238.8	1262.39	1362.05

Burimi: Balancat e energjisë hartuar nga MZHE-ja




Figura 3. Pasqyra e konsumit të produkteve energjetike sipas sektorëve për periudhën 2013-2015 (ktoe)

Konsumi final për përdorim jo energjetik për vitin 2015 ka qenë 46.32 ktoe. Torfa është lloj i vetëm i thëngjillit i cili është konsumuar për qëllime jo energjetike dhe atë në sektorin e industrisë kimike në sasi prej 0.85 ktoe. Ndërsa prej nën-produkteve të naftës, bitumeni (i cili shfrytëzohet në masën dërmuese në shtruarjen e rrugëve-trajtohet si industri ndërtimore) është konsumuar në sasi prej 40.45 ktoe kurse lubrifikantet e shfrytëzuara në industrinë kimike janë në sasi prej 5.02 ktoe.

Në Tabelën 4. është paraqitur gjendja e konsumit final për përdorime jo energjetike për periudhën 2013-2015.

Tabela 4. Konsumi final jo-energjetik sipas nën-sektorëve industrialë (ktoe)

Sektorët ekonomikë	2013	2014	2015
Industria kimike	0.44	0	0.85
Industritë tjera	41.93	33.55	45.47
Gjithsej	42.37	33.55	46.32

3.2.1. Sektori i industrisë

Produktet e naftës, në sektorin e industrisë, zënë pjesën më të madhe të produkteve të energjisë me një pjesëmarrje prej 53.9% ku 40.5% e tyre konsumohet për qëllime energjetike, kurse 13.4% për qëllime jo-energjetike, pasuar nga energjia elektrike me një pjesëmarrje prej 35.9%, thëngjilli me një pjesëmarrje prej 6.1%, ku 5.9% konsumohet për qëllime energjetike, biomasa me një pjesëmarrje prej 4.2% që njëherë është burimi energjetik më pak i konsumuar.




Figura 4. Pasqyra e konsumit të produkteve energjetike në sektorin e industrisë për periudhën 2013-2015 (ktoe)

3.2.2. Sektori i amvisërisë

Energjia elektrike është produkti më i konsumuar i energjisë me një pjesëmarrje prej 48.4% të totalit të konsumit të energjisë, pasuar nga biomasa me një pjesëmarrje prej 44.1%, produktet e naftës me një pjesëmarrje prej 3.7%, thëngjilli me një pjesëmarrje prej 2.7 %, ngrohja e përfituar me 1.1% dhe energjia solare me 0.02%.




Figura 5. Pasqyra e konsumit të produkteve energjetike në sektorin e amvisërisë për periudhën 2013-2015 (ktoe)

3.2.3. Sektori i shërbimeve

Energjia elektrike është burimi më i preferuar i energjisë së konsumuar në sektorin e shërbimeve me një pjesëmarrje prej 47.4% të totalit të energjisë, pasuar nga produktet e naftës me një pjesëmarrje prej 27.8%, thëngjilli 17.7%, biomasa me një pjesëmarrje prej 4.8%, ngrohja e përfituar me një pjesëmarrje prej 2.2% dhe energjia solare me një pjesëmarrje prej 0.2%.




Figura 6. Pasqyra e konsumit të produkteve të energjisë në sektorin e shërbimeve për periudhën 2013-2015 (ktoe)

3.2.4. Sektori i bujqësisë

Në sektorin e bujqësisë, nafta dhe produktet e saj zënë vendin kryesor në konsumin e përgjithshëm të sektorit, me një pjesëmarrje prej 82.5% të totalit të konsumit të energjisë, pasuar nga energjia elektrike me një pjesëmarrje prej 10.2% dhe thëngjilli merr pjesë me 4% dhe biomasa me një pjesëmarrje prej 3.3 %.




Figura 7. Pasqyra e konsumit të burimeve të energjisë në sektorin e bujqësisë për periudhën 2013-2015 (ktoe)

3.2.5. Sektori i transportit

Në sektorin e transportit konsumohen vetëm produkte të naftës. Nafta është produkti energjetik më i konsumuar në këtë sektor me një pjesëmarrje prej 78.9% nga totali i energjisë, pasuar nga benzina me 17.5%, GLN - ja 2.6% dhe kerozina me 1%.




Figura 8. Pasqyra e konsumit të derivateve të naftës në sektorin e transportit për periudhën 2013-2015 (ktoe)

4. Parashikimi i kërkesës për energji për vitin 2016

Parashikimi i kërkesës për energji në të gjithë sektorët është bërë duke u bazuar në:

- pasqyrën energjetike të periudhës 2013-2015 (duke pasur parasysh konsumin e parashikuar të energjisë për vitin 2015 mbi bazën e rritjes ekonomike të Kosovës për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, të dhënat e grumbulluara për importin dhe eksportin e lëndëve djegëse për periudhën Janar-Shtator 2015 ndërsa për periudhën e tremujorit të fundit 2015 janë bërë ekstrapolime);
- të dhënat për rritjen ekonomike me 4.1%¹ të BPV-së për vitin 2016 ;
- rritjen në shkallën 1 % të numrit të amvisërive;
- Balancën e energjisë elektrike për vitin 2016 të hartuar nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut dhe miratuar nga MZHE-ja, ku janë pasqyruar të dhënat e energjisë elektrike për prodhimin, importin, eksportin, humbjet në bartje, humbjet në distribucion, prodhimin e thëngjillit dhe mazutit si dhe emetimin e ndotësve në mjedis,
- të dhënat për parashikimin e energjisë për ngrohje për sezonin 2015/2016 nga ngrohtoret “TERMOKOS” dhe Ngrohtorja e Qytetit të Gjakovës.

Pra, për parashikimin e rritjes së konsumit të energjisë në Kosovë për vitin 2016 është marrë parasysh rritja e llogaritur e rritjes ekonomike në këtë vit që është llogaritur të jetë 4.1%.

Figura më poshtë paraqet rritjet ekonomike prej vitit 2012, 2013, 2014 dhe parashikimin për vitet 2015 dhe 2016.

¹ Bazuar në parashikimin e rritjes ekonomike për vitet 2015 dhe 2016 nga Ministria e Financave




Figura 9. Trendi i rritjes ekonomike në Kosovë për periudhë 2012-2016

4.1. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e amvisërisë

Numri i popullsisë është faktor i rëndësishëm për llogaritjen e kërkesës për energji në sektorin e amvisërisë.

Kërkesat për energji, në sektorin e konsumit të amvisërive, janë më shumë në varësi të drejtpërdrejt me numrin e amvisërive (ku një amvisëri mund të ketë më shumë se një familje) sidomos kur kemi të bëjmë me konsumin e drurit për zjarr, se sa me numrin e popullsisë. Prandaj vlerësimi më i drejt i numrit të familjeve paraqet interes themelor në parashikimet e konsumit të energjisë në sektorin e amvisërisë.

Tabela 5: Parashikimi i konsumit të energjisë në sektorin e amvisërisë për vitin 2016 (në ktoe)

Thëngjill	Produkte nafte	Biomasë	Energji elektrike	Energji solare	Ngrohje e përfituar	Gjithsej
14.46	20.02	236.27	230.45	0.13	12.58	513.90

Gjatë vitit 2016 parashihet të kemi një ulje të konsumit të energjisë në përgjithësi rreth 3% në krahasim me vitin 2015.

Në vitin 2016, bazuar në trendin e trevjeçarit të fundit, pritet rritje e konsumit të thëngjillit nga 14.31ktoe në 14.46 ktoe, po ashtu pritet rritje e konsumit të biomasës nga 233.93 ktoe në 236.27 ktoe, të produkteve të naftës nga 19.40 ktoe në 20.02 ktoe, ngrohja e përfituar nga 5.98 ktoe në 12.58 ktoe, ndërsa konsumi i energjisë elektrike pritet të ulet nga 256.84 ktoe në 230.45 ktoe.




Figura 10. Pjesëmarrja e te gjitha produkteve energjetike në sektorin e amvisërisë

4.2. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e shërbimeve

Në vijim paraqitet parashikimi i konsumit të burimeve të energjisë në sektorin e shërbimeve:

Tabela 6: Parashikimi i konsumit të energjisë në sektorin e shërbimeve (në ktoe)

Thëngjill	Produkte nafte	Biomasa	Energji elektrike	Energji solare	Ngrohje e përfitur	Gjithsej
27.55	43.63	7.27	65.59	0.30	6.77	151.11

Kërkesa për energji elektrike në sektorin e shërbimeve për vitin 2016 parashihet të ulet nga 70.77 ktoe sa ishte në vitin 2015 në 65.59 ktoe. Konsumi i ngrohjes parashihet të rritet nga 3.22 ktoe në vitin 2015 në 6.77 ktoe në vitin 2016, thëngjilli rritet nga 26.46 ktoe në 27.55 ktoe, produktet e naftës nga 41.47 ktoe në 43.63 ktoe dhe konsumi i druve të zjarrit do të rritet nga 7.16 ktoe në 7.27 ktoe.




Figura 11. Pjesëmarrja e te gjitha produkteve të energjisë në sektorin e shërbimeve

4.3. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e industrisë

Në vijim paraqitet parashikimi i konsumit të burimeve të energjisë në sektorin e industrisë:

Tabela 7. Parashikimi i konsumit të burimeve të energjisë në sektorin e industrisë (ktoe)

	Thëngjill	Produkte Naftë	Biomasë	Energji Elektrike	Gjithsej
Konsumi final i përgjithshëm i energjisë	21.52	197.62	14.81	118.34	352.29
Konsumi final për qëllime energjetike	20.64	148.09	14.81	118.34	301.88
Konsumi final për qëllime jo-energjetike	0.88	49.53	0.00	0.00	50.41

Konsumi i energjisë për qëllime energjetike dhe jo-energjetike, në total, në sektorin e industrisë parashihet që për vitin 2016 të jetë 352.29 ktoe. Energjia elektrike në sektorin industrial parashihet të ketë ulje nga 121.70 ktoe në vitin 2015 në 118.34 ktoe në vitin 2016, thëngjilli për qëllime energjetike do të ketë rritje nga 19.90 ktoe në 20.64 ktoe, ndërsa për qëllime jo energjetike rritje nga 0.85 ktoe në 0.88 ktoe, produktet e naftës për qëllime energjetike, parashihet të rriten nga 137.39 ktoe në 148.09 ktoe, ndërsa për qëllime jo energjetike parashihet një rritje nga 45.47ktoe në 49.53 ktoe, biomasa nga 14.09 ktoe në 14.81 ktoe.

4.4. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e transportit

Tabela 8: Parashikimi i konsumit të produkteve energjetike në sektorin e transportit (ktoe)

Naftë	Benzinë	Kerozinë	GLN	Gjithsej
302.95	63.20	3.98	10.06	380.20

Sektorin e transportit karakterizohet me konsumin e derivateve të naftës. Në sektorin e transportit për vitin 2016 parashihet një rritje e konsumit të energjisë për 2.1% nga konsumi i vitit 2015. Pra, në total konsumi i produkteve të energjisë në sektorin e transportit parashihet të rritet nga 372.36 ktoe në vitin 2015 në 380.20 ktoe në vitin 2016.




Figura 13. Pjesëmarrja e të gjitha produkteve të energjisë në sektorin e transportit

4.5. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e bujqësisë

Në vijim paraqitet kërkesa e konsumit të produkteve energjetike në sektorin e bujqësisë: Për vitin 2016 konsumi i sektorit të bujqësisë parashihet të jetë 22.77 ktoe.

Siç shihet në tabelën dhe grafikun në vijim nafta dhe produktet e saj paraqesin produktin energjetik që përdoret më së shumti në sektorin e bujqësisë me një sasi prej 14.19 ktoe ose 62.3% të konsumit total, pasuar nga energjia elektrike me 7.31 ktoe ose 32.1%, thëngjilli me 0.69 ktoe ose 3% dhe biomasa me 0.58 ktoe ose 2.5%

Tabela 9. Parashikimi i konsumit të produkteve energjetike në sektorin e bujqësisë (ktoe)

Thëngjill	Produkte naftë	Biomasa	Energji elektrike	Gjithsej
0.69	14.19	0.58	7.31	22.77




Figura 14. Pjesëmarrja e të gjitha produkteve të energjisë në sektorin e bujqësisë

4.6. Parashikimi i nevojave të përgjithshme (totale) për konsumin final të produkteve energjetike për vitin 2016

Në vijim paraqitet parashikimi i konsumit të të gjitha produkteve energjetike për vitin 2016:

Tabela 10. Pasqyra e parashikimit të konsumit të të gjitha produkteve energjetike për vitin 2016 (ktoe)

Thëngjill	Produkte naftë	Biomasa	Energji elektrike	Ngrrohje e përfituar	Energji solare	Gjithsej
64.21	655.65	258.93	421.69	19.35	0.43	1420.26

Nga të dhënat e grumbulluara dhe analizat del se nafta dhe produktet e saj do të vazhdojnë të jenë pjesëmarrësit më të mëdhenj në konsumin total të produkteve energjetike për qëllime energjetike dhe jo-energjetike, me 46.2% ose 655.65 ktoe, energjia elektrike merr pjesë me 29.7% ose 421.69 ktoe, biomasa merr pjesë me 18.2% ose 258.93 ktoe, ndërsa thëngjilli merr pjesë me 4.5% ose 64.21 ktoe, ngrohja e përfituar 1.4% ose 19.35 ktoe, kurse energjia solare merr pjesë me një pjesëmarrje 0.03% në konsum të energjisë respektivisht 0.43 ktoe.




Figura 15. Pjesëmarrja e të gjitha produkteve energjetike në konsumin total të energjisë

5. Parashikimi i humbjeve të energjisë për vitin 2016

5.1. Humbjet e energjisë elektrike

Humbjet e energjisë elektrike ndahen në:

- Humbjet në rrjetin e transmisionit, që paraqesin diferencën e vlerave të matura të energjisë elektrike në hyrje të transmisionit dhe atyre të matura në dalje të rrjetit transmetues. Këtu përfshihen edhe humbjet për shkak të transitit (pikat matëse në linjat interkonektive 400, 220 dhe 110kV transferohen në kufijtë ndarës duke përdorur koeficientet e aprovuar të transferimit).
- Humbjet në rrjetin e shpërndarjes (distribucionit), që janë diferenca e vlerave të matura të energjisë elektrike së pranuar në pikat e ndarjes nga rrjeti i transmisionit dhe hyrjet nga gjeneratorët e kyçur në shpërndarje dhe në anën tjetër vlerave të matura të energjisë elektrike të dërguar konsumatorëve.

Në planifikimin e humbjeve të tëra në rrjetin e transmisionit përfshihen humbjet e shkaktuara nga ngarkesa e konsumit të Kosovës dhe humbjet e shkaktuara nga energjia elektrike që kalon si tranzit.

Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e transmisionit janë planifikuar të jenë 1,78% të sasisë së gjithmbarshme të energjisë në dispozicion (tabela në paragrafin 4.8) (Prodhimi në prag të transmisionit dhe importi i planifikuar) ose **113 GWh**.

Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes janë planifikuar të jenë **1 114.3 GWh** ose **24.15%** e kërkesës totale të distribucionit. Këtu bëjnë pjesë: humbjet teknike, humbjet komerciale dhe energjia e pa faturuar në pjesën veriore të Kosovës.

5.2. Humbjet e ngrohjes qendrore

Humbjet e ngrohjes qendrore në rrjetin e bartjes dhe shpërndarjes do të jenë **50.8 GWh**.

6. Parashikimi i prodhimit të energjisë elektrike për vitin 2016

6.1. Parashikimi i prodhimit të energjisë elektrike nga termocentralet

Prodhimi vjetor i energjisë elektrike në TC planifikohet deri në vlerën e shfrytëzimit optimal të kapaciteteve prodhuese.

Energjia elektrike e dhënë në prag të transmisionit nga TC Kosova A dhe TC Kosova B planifikohet të jetë: **5 668,8 GWh**, ku:

- TC Kosova A = **1 983,4 GWh**, në prag të transmisionit.
- TC Kosova B = **3 685,4 GWh**, në prag të transmisionit.

6.2. Parashikimi i prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet dhe burimet e ripërtritshme

Prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga HC Ujmani dhe HC-Kaskada e Lumbardhit (HC Lumbardhi 1, HC EGU Belaje dhe HC EGU Deçani), të cilat janë të kyçura në nivelin e transmisionit planifikohet:

- HC Ujmani = **95 GWh**.
- HC-Kaskada e Lumbardhit = **63 GWh**

Prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga hidrocentralet, burimet e energjisë nga era, nga panelet diellore-LED LIGHT Technology, të kyçura në sistemin e shpërndarjes planifikohet:

- HC Radavci = 4,7 GWh,
- HC Istogu = 2,0 GWh,
- HC Dikance = 12,4 GWh,
- HC Brodi 2 = 21,1 GWh,
- HC Hydroline-AlbanikuIII = 20 GWh,
- HC Restelica 1&2 = 1,9 GWh, (pritet të kyçet në Tetor të vitit 2016)
- Led Light tehnology = 0,13 GWh
- Gjeneratorët me erë, = 1,7 GWh

Energjia elektrike e gjithmbarshme në prag të transmisionit e prodhuar nga TC Kosova A, TC Kosova B dhe HC Ujmani dhe HC-Kaskada e Lumbardhit për vitin 2016, është planifikuar të jetë **5 827,1 GWh**.

Ndërsa, prodhimi i tërë i Kosovës, duke përfshirë edhe HC Distributive dhe gjeneratorët me erë si dhe fotovoltaike, planifikohet të jetë **5 891,3 GWh**.

Balanca Vjetore e Energjisë e Republikës së Kosovës për vitin 2016

Tabela 11: Parashikimi i prodhimit, importit, konsumit dhe humbjeve në bartje në sistemin elektroenergjetik

	MWh	Gjithësejt	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1	Kosova A - Prodhimi në prag të transmisionit	1,983,439	170,425	152,671	171,140	161,700	167,599	164,769	161,719	168,902	162,711	171,855	157,666	172,282
2	Kosova B - Prodhimi në prag të transmisionit	3,685,460	366,141	330,172	368,489	253,010	374,499	362,039	206,246	148,909	286,582	373,076	249,166	367,132
3	Ujmani + Kaskada e Lumbardhit	158,214	14,188	11,528	12,278	17,628	20,355	16,916	9,225	6,534	8,072	10,945	14,098	16,446
4	Prodhimi i HC, LLT dhe WP të kyçura në Distribucion	64,226	4,923	5,173	5,709	6,178	7,453	6,404	4,573	3,421	3,869	4,560	5,783	6,179
5	(1+2+3+4) Prodhimi Nacional	5,891,339	555,676	499,544	557,616	438,516	569,907	550,129	381,763	327,765	461,234	560,436	426,714	562,039
6	(1+2+3) Prodhimi (hyrja në transmision)	5,827,113	550,754	494,371	551,907	432,337	562,453	543,725	377,189	324,345	457,365	555,876	420,930	555,861
7	Importi	541,320	81,720	46,950	26,800	73,320	0	0	47,040	79,940	14,950	5,600	90,480	74,520
8	(6+7) Energjia në disponim	6,368,433	632,474	541,321	578,707	505,657	562,453	543,725	424,229	404,285	472,315	561,476	511,410	630,381
9	Trepça	25,855	2,466	2,159	2,331	2,035	2,214	2,001	1,971	1,817	1,968	2,121	2,115	2,658
10	Sharrceci sh.a	64,837	862	1,125	5,200	6,300	6,700	6,850	6,850	6,800	6,950	6,800	6,000	4,400
11	NewCo Ferronikeli sh.a	639,473	54,163	50,668	54,163	52,416	54,163	52,416	54,163	54,163	52,416	54,163	52,416	54,163
12	Mihjet	121,000	11,000	11,000	10,000	10,000	9,000	9,000	9,000	10,000	10,000	10,000	11,000	11,000
13	Shpenzimet e TC nga transmisioni	151,930	12,168	11,329	12,399	11,725	11,998	12,188	9,284	13,742	13,473	14,147	14,537	14,940
14	Kërkesa e Distribucionit	4,549,946	519,683	421,113	424,193	388,915	333,336	304,316	320,148	304,273	309,138	345,204	381,477	498,150
15	(9+10+11+12+13+14) Kërkesa neto	5,553,041	600,342	497,394	508,285	471,392	417,412	386,772	401,416	390,795	393,945	432,434	467,544	585,311
16	Humbjet në transmision	113,918	11,551	9,819	10,411	8,892	10,124	9,787	7,566	7,258	8,502	10,006	8,849	11,153
17	Mungesa	0												
18	Teprica (eksport)	701,474	20,581	34,108	60,010	25,374	134,917	147,166	15,247	6,232	69,868	119,036	35,017	33,917
19	(15+16) Kërkesa gjithsejt	5,666,959	611,893	507,213	518,697	480,284	427,536	396,559	408,982	398,053	402,446	442,440	476,393	596,464
20	(17+18+19 -8) Balanca	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Burimi: Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2016.-Operatori i Sistemit të Bartjes dhe Tregut i Kosovës (KOSST)

- * Shpenzimet e TC Kosova A dhe TC Kosova B nga transmisioni janë shpenzime të cilat merren nga transmisioni për nevoja të gjenerimit.
- ** Mungesat paraqiten për shkak të mungesës së fuqisë në muaj të caktuar të sezonit të dimrit dhe për shkak të remonteve të njëjësive gjeneruese.
- *** Tepricat (eksporti) paraqiten zakonisht në sezonin e verës dhe atë si teprica gjatë natës.

6.3. Parashikimi i importit të energjisë për vitin 2016

Nga shuma totale e nevojave të parashikuara për burime primare të energjisë prej 2495.78 ktoe për vitin 2016 në Kosovë, një pjesë e konsiderueshme e kësaj sasive do të importohet. Në realitet 29.2% e energjisë bruto në Kosovë importohet. Kryesisht do të importohen derivate të naftës, energji elektrike, thëngjilli dhe një sasi e vogël biomase. Energjia e importuar planifikohet të jetë 729.72 ktoe.

Në importin e energjisë kryesisht dominon nafta me 670.45 ktoe që paraqet 91.88% të energjisë së përgjithshme të importuar. Energjia elektrike parashihet të importohet në sasi prej 46.55 ktoe ose 6.38% e energjisë së importuar dhe thëngjilli me 7.29 ktoe që është 1% të energjisë së importuar dhe biomasa me 5.43 ktoe ose 0.74%.

Në Tabelën 12 paraqitet parashikimi për importin e burimeve të energjisë për vitin 2016:

Tabela 12: Pasqyra e parashikimit të importit të produkteve energjetike për vitin 2016 (ktoe)

Produkte naftë	Energji Elektrike	Thëngjill	Biomasa	Gjithsej
670.45	46.55	7.29	5.43	729.72
91.88%	6.38%	1.00%	0.74%	100%

Në vijim paraqitet parashikimi i prodhimit, konsumit dhe rezervave të thëngjillit për 2016 për termocentralet ekzistuese:

Tabela 13: Parashikimi i prodhimit, konsumit dhe rezervave të thëngjillit për vitin 2016

KEK	Prodhimi i qymyrit			Konsumi i qymyrit			Tregu *	Nevojat	Gjendja me: 31.12.15		
	Sitnica	SJP	Total	TC A	TC B	TC A+B			DEPO 500 000	DEPO A 200 000	DEPO B 300 000
1	0	700 000	700 000	277 345	501 633	778 978	10 000	788 978	411 022	164 409	246 613
2	0	660 000	660 000	248 325	450 619	698 944	10 000	708 944	362 078	144 831	217 247
3	0	720 000	720 000	278 588	501 633	780 221	10 000	790 221	291 857	116 743	175 114
4	0	710 000	710 000	263 664	340 090	603 754	10 000	613 754	388 103	155 241	232 862
5	0	730 000	730 000	273 614	501 633	775 247	10 000	785 247	332 856	133 142	199 714
6	0	700 000	700 000	268 639	484 628	753 267	10 000	763 267	269 589	107 836	161 753
7	0	700 000	700 000	268 639	274 177	542 816	10 000	552 816	416 773	166 709	250 064
8	0	600 000	600 000	273 614	196 590	470 203	25 000	495 203	521 569	208 628	312 942
9	0	650 000	650 000	263 664	382 170	645 834	25 000	670 834	500 736	200 294	300 441
10	0	730 000	730 000	278 588	501 633	780 221	10 000	790 221	440 515	176 206	264 309
11	0	750 000	750 000	253 714	340 090	593 805	10 000	603 805	586 710	234 684	352 026
12	0	750 000	750 000	278 588	501 633	780 221	10 000	790 221	546 489	218 595	327 893
Gjithësejt	0	8 400 000	8 400 000	3 226 982	4 976 529	8 203 511	150 000	8 353 511			

7. Parashikimi i emetimit të ndotësve nga termocentralet

Ndotësit kryesorë të ajrit nga termocentralet janë këto produkte të djegies:

- hiri (grimcat e pluhurit)
- gazi SO₂
- gazi NO_x
- gazi CO₂

7.1. Emetimet specifike të TC Kosova A

Në vijim paraqitet parashikimi i emetimeve specifike nga termocentrali Kosova A për vitin 2016:

Tab.14. Parashikimi i emetimeve specifike të TC Kosova A

Muaji	Prodhimi në gjenerator (MWh)	A3+A4+A5				Prodhimi i hirit
		Pluhur	SO2	NOx	CO2	
		kg/MWh				
		0.30	3.02	3.90	1470	
Emisionet e parallogaritura për vitin 2016						
1	182 464	48 718	357 629	620 376	230 816 448	43 791 263
2	163 372	43 620	320 209	555 464	206 665 250	39 209 217
3	183 282	48 936	359 232	623 158	231 851 499	43 987 636
4	173 463	46 315	339 988	589 775	219 430 883	41 631 156
5	180 009	48 062	352 817	612 030	227 711 294	43 202 143
6	176 736	47 189	346 403	600 903	223 571 089	42 416 649
7	176 736	47 189	346 403	600 903	223 571 089	42 416 649
8	180 009	48 062	352 817	612 030	227 711 294	43 202 143
9	173 463	46 315	339 988	589 775	219 430 883	41 631 156
10	183 282	48 936	359 232	623 158	231 851 499	43 987 636
11	166 917	44 567	327 158	567 519	211 150 473	40 060 169
12	183 282	48 936	359 232	623 158	231 851 499	43 987 636
A3-A5	2 123 014	566 845	4 161 108	7 218 249	2685 613 200	509 523 453

7.2. Emetimet specifike te TC Kosova B

Në vijim paraqitet parashikimi i emetimeve specifike nga termocentrali Kosova B për vitin 2016:

Tab.13. Parashikimi i emetimeve specifike të TC Kosova B

Muajt	Prodhimi në gjenerator (MWh)	GJENERATORI B1+B2				Prodhimi i hirit
		Pluhur	SO2	NOx	CO2	
		kg/MWh				
		3.92	2.64	3.40	1 050	
Emisionet e parallogaritura për vitin 2015						
1	411 175	1 618 853	1 087 537	1 569 042	437 920 465	74 716 288
2	369 360	1 454 224	976 940	1 409 478	393 386 180	67 118 021
3	411 175	1 618 853	1 087 537	1 569 042	437 920 465	74 716 288
4	278 762	1 097 527	737 313	1 063 757	296 895 230	50 655 110
5	411 175	1 618 853	1 087 537	1 569 042	437 920 465	74 716 288
6	397 236	1 534 468	1 030 847	1 487 253	415 093 143	70 821 579
7	224 736	876 469	588 807	849 501	237 096 050	40 452 407
8	161 139	618 615	415 582	599 580	167 343 176	28 551 442
9	313 254	1 206 935	810 813	1 169 799	326 491 390	55 704 692
10	411 175	1 618 853	1 087 537	1 569 042	437 920 465	74 716 288
11	278 762	1 087 173	730 357	1 053 722	294 094 332	50 177 232
12	411 175	1 618 853	1 087 537	1 569 042	437 920 465	74 716 288
I - XII	4 079 122	15 969 675	10 728 346	15 478 300	4 320 001 826	737 061 923

8. Indikatorët e efijencës së energjisë së termocentraleve

- Përmirësimi i kualitetit dhe cilësisë së qymyrit
 - Zvogëlimi i shpenzimeve specifike të qymyrit në TCA dhe TCB ton/MWh
 - Zvogëlimi i shpenzimeve vehtiake të energjisë elektrike TCA, TCB dhe Miniera
 - Zvogëlimi i shpenzimeve specifike të karburanteve naftë lit/MWh në TCA dhe mazut ton/MWh në TCB duke zvogëluar rëniet e pa planifikuara
 - Liferimi i pjesëve të ndërrimit me kualitet adekuat
 - Mirëmbajtja dhe operimi në nivel teknik të kërkuar
 - Kryerja e remonteve me kohë dhe kualitative
- Përmbajtja e qymyrit të mihjeve:
- Aftësia e ulët termike 6700 – 9210 kJ/kg, vlera projektuese 7325.5 kJ/kg
 - Përmbajtja e hirit 14 – 21 %
 - Përmbajtja e lagështisë 38 – 47 %
 - Përmbajtja e sulfurit gjatë djegies është 0.3 %

Llogaritja e koeficientit të efijencës në prag do të jetë:

- Llogarisim me vlerë të aftësisë së ulët termike të qymyrit $Kq=1863\text{kcal/kg}=7800\text{ kJ/kg}$
- Harxhimi specifik i qymyrit në TC Kosova A $hsq=1.52\text{ ton/MWh}$ në gjenerator
- Harxhimi specifik i qymyrit në TC Kosova B $hsq=1.22\text{ ton/MWh}$ në gjenerator

Llogaritja e koeficientit të efijencës së energjisë së Termocentraleve Kosova A dhe B:

$$\text{TC Kosova A} = 7800 * 1.52 = 11856 \text{ kJ/kWh}$$

$$E_f = E_d / * 100\% = 3600 / 11856 = 30.36 \%$$

$E_d=3600\text{ kcal/kWh}$ - energjia specifike elektrike
-energjia specifike e mesme e qymyrit në hyrje (termike)

$$\text{TC Kosova B} = 7800 * 1.22 = 9515 \text{ kJ/kWh}$$

$$E_f = E_d / * 100\% = 3600 / 9516 = 37.83 \%$$

Shtojca. Balanca Vjetore e Energjisë për vitin 2016

Balanca Vjetore e Energjisë e Republikës së Kosovës për vitin 2016

Balanca Vjetore e Energjisë për vitin 2016 (ktoe)	Biomasë	Bio-karburante	Hydroenergji	Energji solare	Energjia gjeotermale	Energji e erës	Energjia fotovoltaike	Ngrrohje e përfituruar	Energji Elektrike
Prodhimi primar	253.54		18.97	0.43	0.00	0.150	0.012		
Prodhimet e përfituara									
Importet	5.43	0.00	0.00						46.55
Diferenca e stokut									
Eksportet	0.04	0.00	0.00						60.33
Bunkerët									
Konsumi i brendshëm bruto	258.92	0.00	18.97	0.43	0.00	0.15	0.01		-13.77
Hyrja në transformim	0.00	0.00	0.00	0.43		0.00	0.00		0.00
Termocentralet									
Termocentralet me prodhim automatik									
Centralet bërthamore									
Impiantet me lëndë djegëse të patentuara dhe brikete									
Impiantet me furrë koksi									
Impiantet me furrë martin									
Stacionet e gazifikimit									
Rafineritë									
Impiantet e ngrrohjes qendrore									
Panele solare				0.43					
Daljet nga Transformimi	0.00	0.00	0.00	0.43	0.00	0.00	0.00	23.79	533.38
Termocentralet									533.38
Termocentralet me prodhim automatik									
Centralet bërthamore									
Impiantet me lëndë djegëse të patentuara dhe brikete									
Impiantet me furrë koksi									
Impiantet me furrë martin									
Stacionet e gazifikimit									
Rafineritë									
Impiantet e ngrrohjes qendrore								23.79	
Panele solare				0.43					
Shkëmbimet dhe transferet, kthimet	0.00		-18.97		0.00	-0.15	-0.01		19.13
Transferet e mesproduktit			-18.97			-0.15	-0.01		19.13
Produktet e transferuara									
Kthimet nga industria petrokimike									
Humbjet në transformim	0.00								
Konsumi nga degët e energjisë (vetkonsumi)								0.07	59.34
Humbjet në bartje dhe shpërndarje								4.37	57.71
Në dispozicion për konsum final	258.92	0.00	0.00	0.43	0.00	0.00		19.35	421.69
Konsumi final jo-energjetik	0.00								0.00
Industria kimike	0.00								
Sektorët tjerë	0.00								
Konsumi final i energjisë	258.93	0.00	0.00	0.43	0.00	0.00		19.35	421.69
Industria	14.81	0.00	0.00			0.00			118.34
Industria e hekurit dhe çelikut	0.55								48.17
Industria e metaleve jo-ferrore	0.00								1.53
Industria kimike	0.04								0.26
Industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore	0.82								5.79
Industria e nxjerrjes së xeheve	0.05								1.32
Industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit	5.72								44.27
Industria e tekstilit, lëkurës dhe veshëmbathjes	0.00								0.10
Industria e letrës dhe stampimit	0.01								0.18
Inxhinieringu dhe industritë tjera të metaleve	0.00								0.01
Industritë tjera	7.62								16.72
Transporti	0.00	0.00	0.00			0.00			0.00
Transporti hekurudhor									
Transporti rrugor		0.00							
Transporti ajror									
Navigacioni i brendshëm									25
Amvisëria	236.27	0.00	0.00	0.13		0.00		12.58	230.45
Bujqësia	0.58	0.00	0.00	0.00		0.00			7.31
Shërbimet	7.27	0.00	0.00	0.30	0.00	0.00		6.77	65.59
Diferenca statistikore	-0.01	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00	0.00

